

## PROCESVERBAL 23/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 9 (nëntë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 23.09.2024 duke filluar nga ora 9:00.

### Rend dite

**1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2025;**

**3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga taksa në aktivitet;**

**4.Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

**Aprovohet rendi i ditës**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Denis Sofra** - e hedh në votim pikën 1.

**Aprovohet pika 1**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2025;**

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që buxheti për vitin 2025 është 23.284.922,00€.Këto mjete janë të mdara në kategorinë paga dhe meditime,mallra dhe shërbime,komunali,investime kapitale.Ky projekt-vendim në KPF ka kalu pa asnjë ndryshim për arsye që ne kemi pas disa takime me qytetar dhe kemi pas një takim të fundit me KPF-në dhe përfaqësues të grupeve parlamentare që përfaqësojnë subjektet politike në kuvendin e komunës.

**Denis Sofra** - hap debatin.Nuk ka debat,e hedh në votim pikën 2.

**Aprovohet pika 2**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga taksa në aktivitet;**

**Avni Bytyqi** - zyrtari ligjor thotë që në rrugën “Skënderbeu” dhe në shesh janë duke u bë punimet pothuaj që një vit dhe si pasojë e punimeve kemi analizu dhe kemi konstatu që pak a shumë ne i kemi dëmtu bizneset në çështjen e ushtrimeve të aktiviteteve të tyre për këtë periudhë dhe komuna ka shpreh gatishmërinë që këto biznese që ushtrojnë veprimtarinë në rrugën “Skënderbeu” dhe sheshin në Suharekë ti lirojmë për vitin 2024-2025.

**Denis Sofra** - hap debatin.Nuk ka debat,e hedh në votim pikën 3.

**Aprovohet pika 3.**

**Pika 4. Të ndryshme;**

**Denis Sofra** - hap debatin.Nuk ka debat.

Takimi përfundoi: 09:15